



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1093

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Center for Legal Services L.L.C., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës, me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1, me 15.12.2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e Center for Legal Services L.L.C., me nr. 2025/1093, e datës 06.11.2025 dhe anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1.

2. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSh. Nr. 0379/2025 dhe Vendimin PSh. 0708/2025, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. I shqiptohet vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit për mos zbatim të vendimeve të OSHP, së, në rastë të përsërtijes, OSHP do të ndërmarrë masa konform nenit 97 të Rregullorës për Prokurim Publik.

5. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.04.2025, Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1. Ndërkaq me datën 21.10.2025 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK ku është rekomanduar për kontratë grupin e OE Ekrem Q Salihu B.I.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 115,000.00 €

Me 25.10.2025, OE Center for Legal Services L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.10.2025, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.11.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Center for Legal Services L.L.C., me nr. 2025/1093 lidhur me aktivitetin Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Ankesa është e përsëritur, lidhur me këtë lëndë janë nxjerr vendimet e mëparshëm të OSHP - së, më Nr. 0379/2025 dhe vendimin me Nr. 0708/2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Center for Legal Services L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Fillimisht duhet sqaruar se OSHP deri më tani ka marrë dy (2) vendime lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Me datë 10.07.2025 OSHP ka marrë vendimin 2025/0379, ndërsa me datë 06.10.2025 OSHP ka marrë vendimin 2025/0708. Në të dy rastet OSHP i ka miratuar si të bazuara ankesat e avokaturës CLS Law Firm, ndërsa aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim. Pavarësisht që në vendimet e OSHP është konstatuar pa mëdyshje që oferta e avokaturës CLS është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit, sërish AK insiston ose të shpërblejë me kontratë OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”, ose të anulojë aktivitetin e prokurimit në tërësi. Me datë 05.05.2025 AK kishte publikuar njoftimin e parë mbi vendimin përmes të cilit e kishte rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”. Megjithatë, pas ankesës që ne kemi parashtruar në OSHP, Paneli Shqyrtues përmes vendimit të OSHP 2025/0379 kishte konfirmuar që pretendimet tona ankimore kundër këtij OE janë të bazuara, rrjedhimisht kishte gjetur se oferta e dorëzuar nga OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” është e papërgjegjshme sepse nuk i përmbushë kërkesat themelore të dosjes së tenderit.

Pavarësisht vendimit OSHP 2025/0379, AK me datë 21.10.2025 ka publikuar njoftimin B58 (të tretin me radhë) përmes të cilit sërish e ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”. Një veprim i tillë nga AK përbën shkelje flagrante të vendimeve të OSHP të cituara më sipër (2025/0379 dhe 2025/0708).

PRETENDIMI NR. 1 – AK ka shkelur nenin 97 par. 1 nënpar. h) të RRPP:

Përmes nenit 97 par. 1 nënpar. h) përcaktohet se “Mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së” është shkelje e rëndë disiplinore në procedurën e prokurimit publik. Në rastin konkret OSHP përmes vendimit nr. 2025/0379 ka miratuar në tërësi ankesën tonë (të gjitha pretendimet ankimore janë miratuar në tërësi). Në këtë mënyrë përmes vendimit OSHP:2025/0379 është evidentuar si vijon:

OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” është i papërgjegjshëm për arsye se ka ndërhyrë në paramasë, ka plotësuar gabimisht formularin e çmimit në dosjen e tenderit (devijimi aritmetik mbi 2%), si dhe ka vendosur çmime në paramasë të cilat janë peshuar gabimisht dhe jo sipas formularit të përcaktuar në paramasë.

Po ashtu, edhe për OE “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.”, AK pas rivlerësimit nuk ka prezantuar arsyet eliminuese të evidentuara në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar në vlerësimin e parë (përkundër faktit që oferta e këtij OE është e njëjta, nuk ka ndryshuar dhe mbi të gjitha vetë OE nuk i ka kundërshtuar asnjëherë këto arsye).

OE “Juris Concept” – referenca e dorëzuar lidhur me kontratën e realizuar sipas listës së kontratave nuk i ka përmbushur kërkesat e cekura specifikisht në DT (mungon vlera e kontratës në referencë, por edhe në listën e kontratave). Po ashtu ka plotësuar gabimisht formularin e çmimit në dosjen e tenderit (devijimi aritmetik mbi 2%).

Duke qenë se AK ka shkelur vendimet e OSHP (2025/0379 dhe 2025/0708), CLS Law Firm tani po detyrohet që në vijim të parashtrojë pretendimet e njëjta ankimore kundër tenderuesit të rekomanduar “Ekrem Q. Salihu B.I.”, por edhe ofertuesve të tjerë.

PRETENDIMI NR. 2 – kundër tenderuesit të rekomanduar OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”:

Tenderuesi i rekomanduar në ofertën e tij nuk ka dorëzuar paramasën e cila ka qenë pjesë e DT sikurse është publikuar në e-prokurim. Me fjalë të tjera tenderuesi i rekomanduar ka ndërhyrë në paramasë duke shtuar edhe një kolonë të re jo vetëm në një pozicion të caktuar, por në komplet paramasën. Paramasa e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar duket si në vijim:

[fig.]

Pra, përgjatë gjithë paramasës tenderuesi i rekomanduar sipas dëshirës së tij ka shtuar edhe një rubrikë të re të cilën e ka plotësuar me disa numra që nuk përputhen as me Tarifën e Odës së Avokatëve dhe as me paramasën që ka qenë pjesë e DT. Përndryshe paramasa e cila ka qenë pjesë e DT në e-prokurim ka qenë si vijon:

[fig.]

Nga sa u tha më sipër, OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” ka ndërhyrë në paramasën e DT. Rrjedhimisht ai ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

PRETENDIMI NR. 3 – kundër tenderuesit të rekomanduar OE “Ekrem Q. Salihu B.I.”:

Përtej të gjeturave të argumentuara si më sipër, tenderuesi i rekomanduar në pjesën e rekapitullimit të çmimit në kuadër të paramasës ka ndërhyrë duke shtuar po ashtu një rubrikë të re me të cilën e ka emërtuar “Çmimi total i peshuar me poentim”. Rrjedhimisht ai ka prezantuar disa çmime për pozicionet përkatëse të paramasës të cilat nuk i ka peshuar sipas kriterëve të përcaktuara me DT, mirëpo i ka peshuar në mënyrë krejt të gabuar. Si shembull, çmimin për kategorinë A e ka prezantuar si 468.64, të cilën më pas e ka peshuar me 397.15 dhe më tutje e ka ripeshuar sërish me 119.15 euro. Këtë vlerën e fundit, që nuk dihet se si është kalkuluar (pra nuk dihet si është arritur deri te kjo shumë), e ka marrë për bazë edhe me rastin e kalkulimit të çmimit final me të cilin ai është rekomanduar për kontratë. Në anën tjetër pesha e kategorisë A ka qenë vetëm 30%. Pra, komplet paramasa, duke përfshirë edhe rekapitullimin, është plotësuar gabimisht nga tenderuesi i rekomanduar. Shih edhe fig. si në vijim:

[fig.]

Nga sa u tha më sipër, OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme prandaj duhet eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të shpërblehet me kontratë.

Lidhur me ofertën e dorëzuar nga “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.” pajtohem me të gjeturat e AK sipas të cilave i njëjti ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, megjithëse ekzistojnë edhe arsye të tjera për papërgjegjshmërinë e kësaj oferte të cilat ne i kemi prezantuar në ankesat tona në OSHP, ndërsa Paneli Shqyrtues i ka konfirmuar si të gjeta të bazuara dhe të sakta.

Lidhur me ofertën e dorëzuar nga “Juris Concept” nuk pajtohem me faktin që AK e ka përcaktuar në letrën standarde si ofertues të pasuksesshëm për faktin që edhe ky OE nuk ka përmbushur kërkesat e DT dhe për këtë arsye është ofertues i papërgjegjshëm. Arsyet eliminuese edhe për këtë OE i kemi prezantuar në ankesat tona në OSHP, ndërsa Paneli Shqyrtues i ka konfirmuar si të gjeta të bazuara dhe të sakta. Prandaj i njëjti duhet të eliminohet si i papërgjegjshëm dhe jo të shpallet si i pasuksesshëm. Përndryshe pajtohem me letrën informuese të AK sipas të cilës “Juris Concept” në këtë aktivitet të prokurimit nuk vazhdon të jetë palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP për faktin që asnjëherë nuk ka kundërshtuar vendimet e AK përmes të cilave nuk është përzgjedhur si fitues.

Vlen të shtohet po ashtu që asnjë nga OE, duke përfshirë edhe tenderuesin e rekomanduar, nuk e kanë vazhduar validitetin e ofertës ose të paktën jo përmes platformës e-prokurimi (duke qenë se në e-prokurim nuk evidentohet asnjë konfirmim nga tenderuesi i rekomanduar apo OE tjerë për vazhdimin e validitetit të ofertës). Përmes nenit 30 par. 6 të RRPP përcaktohet se “OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohen si të papërgjegjshëm”.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. I. Rrethanat e Çështjes

Procesi i tenderimit për aktivitetin e prokurimit “Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës” (nr. VU644-25-2905-2-2-1) është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-237 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092) dhe Rregulloren Nr. 002/2022 për Prokurimin Publik (version i konsoliduar).

Pas shqyrtimit të ankesave të mëhershme dhe vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, përfshirë vendimin OSHP nr. 2025/0708, datë 06.10.2025, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në

zbatim të plotë të urdhërimeve të OSHP-së për rivlerësim të tenderëve dhe për respektim të dispozitave të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores për Prokurimin Publik lidhur me Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahësimin e Tenderëve.

Vendimi i Refuzues i AK – Center for Legal Services L.L.C., SHPK - Nr. 1190/25, dt. 27.10.2025

II. Gjetjet e Komisionit të Rivlerësimit

Komisioni i rivlerësimit, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të tenderëve, ka arritur në këto konstatime faktike:

Tenderët e O.E. “Ekrem Q. Salihu B.I.” dhe “Center for Legal Services L.L.C.” përmbushin kërkesat ligjore, teknike dhe profesionale të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, duke u vlerësuar si tenderues të përgjegjshëm në kuptim të nenit 59 të LPP-së.

Tenderët e O.E. “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.” dhe “Juris Concept L.L.C.” janë vlerësuar si tenderues të përgjegjshëm, për shkak të dokumentuara në raportin e rivlerësimit.

Lidhur me dokumentin “Përshkrimi i Pozicioneve dhe Çmimeve” të dorëzuar nga O.E. “Ekrem Q. Salihu B.I.”, komisioni ka konstatuar se plotësimet shtesë (kolonat e normës së TVSH-së dhe TVSH-së së llogaritur) nuk përbëjnë ndryshim thelbësor apo devijim substancial nga kushtet dhe specifikimet e Dosjes së Tenderit, në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP-së dhe nenit 40.9 të Rregullores Nr. 002/2022.

Plotësimet e përmendura janë të dhëna administrative ndihmëse, që pasqyrojnë më saktë koston reale të shërbimeve të ofertuara dhe nuk cenojnë barazinë në trajtim, konkurrencën apo parimin e transparencës, të garantuar me nenin 7 të LPP-së.

Komisioni ka konfirmuar se dokumenti në fjalë përmban të gjitha të dhënat relevante dhe të domosdoshme për vlerësim, prandaj nuk ka pasur asnjë pengesë për realizimin e procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve në mënyrë të saktë dhe të plotë.

III. Vlerësimi Ligjor

Në përputhje me nenin 59 të LPP-së, komisioni i rivlerësimit ka vlerësuar ofertat bazuar në kriterin për dhënie të kontratës “Çmimi më i ulët” dhe në respektim të parimeve të përcaktuara në nenin 1 (Qëllimi), 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) dhe 7 (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi) të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në këtë kuadër, nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore dhe as elemente që do të përbënin mosrespektim të vendimeve të OSHP-së, në kuptim të nenit 97 par. 1 nënpar. (h) të LPP-së, pasi rivlerësimi është zhvilluar në harmoni të plotë me vendimin OSHP nr. 2025/0708.

Vendimi i Refuzues i AK – Center for Legal Services L.L.C., SHPK - Nr. 1190/25, dt. 27.10.2025

IV. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Vendimi

Duke u bazuar në të gjitha faktet, dokumentet, vlerësimet dhe analizat e përfshira në Raportin e Rivlerësimit të Komisionit Profesional, Autoriteti Kontraktues konstaton sa vijon:

Procesi i rivlerësimit është zhvilluar në përputhje me LPP dhe Rregulloren për Prokurim Publik;

Nuk janë identifikuar shkelje procedurale apo substanciale nga ana e Autoritetit Kontraktues;

Kërkesa për rishqyrtim nuk ofron prova apo argumente të reja që do të ndikonin në ndryshimin të vendimit të datës 21.10.2025 për rekomandimin e O.E. “Ekrem Q. Salihu B.I.” për dhënie të kontratës.

Në fund, A.K. thekson se vërtetohen dhe mbesin në fuqi të gjitha kërkesat, kushtet materiale dhe informatat tjera përkatëse të dosjes së tenderit, duke përfshirë Njoftimin për Dhënie B-58, krejt kjo me arsyen se të njëjtat garantojnë transparencë dhe konkurrencë të drejtë e të barabartë sipas praktikave më të mira për të gjithë OE që zotërojnë kapacitetet e nevojshme të lartcekura në funksion të realizimit me sukses të kontratës në raport me objektin dhe specifikat e fushëveprimtarisë së saj.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.11.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1093/2025, ndërsa me datë 13.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/1093 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertizës. Ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Center for Legal Services L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1093 ka vlerësuar si në vijim:

Sqaroj se në ankesën e operatorit ekonomik ankues, janë paraqitur pretendime të njëjta me pretendimet në dy ankesa paraprake.

Kjo ankese e operatorit ekonomik ankues është për herën e tretë dhe pretendimet janë të njëjta dhe poashtu janë trajtuar edhe nga unë në cilsinë e ekspertit shqyrtues dhe për të njëjtat ka vendim nga Paneli i OSHP-së.

Vendimi i parë i OSHP-së, numër: 2025/0379 i datës: 10/07/2025 dhe,

Vendimi i dytë i OSHP-së, numër : 2025/0708 i datës: 06/10/2025.

Përfundim:

Pretendimet e operatorit ekonomik janë trajtuar dhe ka vendim përfundimtar të OSHP-së dhe të njëjtat konsiderohen si çështje e gjykuar (res judicata).

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se

Paneli ka analizuar në tersi këtë procedurë dhe sipas të gjeturave në këtë procedurë (e-prokurimi) Sipas ‘‘B58Njoftimit mbi vendimin e AK-se’’, të publikuar nga AK-ja , është i shpërblyer me kontratë Ekrem Q. Salihu B.I (Njoftim i dates 05.05.2025), kështu duke klasifikuar OE ankues si tenderues i pa suksesshëm, ndërsa pas vendimit paraprak OSHP:2025/0379 i datës:10.07.2025. AK me datën 14.07.2025, ka publikuar ‘‘B58Njoftim mbi vendimin e AK-se’’ ku ka anuluar në tersi procedurën me arsyetim citohet ‘‘ *Për shkak se asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm...* ’’, ku sipas letrave standardëve për tenderuesit e eliminuar përfshire edhe OE tani më të rekomanduar janë paraqitur te dhënat në mos përmbushjen sipas Rregullores se Tarifave, ku kundër këtij vendimit nga AK-ja ka parashtruar ankesë pran OSHP-se OE ankues por jo edhe OE i rekomanduar për kontratë. Ndërsa pas pranimit të vendimit paraprak të OSHP-se me nr 2025/0708 i datës 06.10.2025, Pavarsishte se në vendim 2025/0379 citohet që obligohet AK- ti përmbahet konstatimeve të raportit të ekspertit shqyrtues sipas konstatimeve në pretendimet ankimore 1, 2 dhe 3 ku Paneli Shqyrtues e kthen procedurën në Rivlerësim për çka nga AK-ja obligohet të veprojnë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore, ku edhe vet AK-ja në përgjigjen e ofruar në raportin e ekspertizës është pajtuar me raportin e ekspertizës citoj ‘‘ *konfirmojm se Pajtohemi me Ekspertizen me Nr. i lëndës 2025/0379.....* ’’, me çka nënkupton se OE i rekomanduar ka ndërhyrë në paramasën e AK-se (Formularin, Përshkrimin e ÇMIMEVE).

Autoriteti Kontraktues shpërblen me kontrate OE tanimë të rekomanduar i cili ishte anuluar fillimisht (sipas NJVK, datës 14.07.2025) nga AK-ja duke shprehur pajtim me vendimin dhe nuk ka ndjekur procedurat e mëtejshme, dhe nga kjo konsiderohet se është pajtuar me vendimin paraprak të AK-se duke mos shfrytëzuar mjetet juridike kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues. Prandaj, bazuar në nenin 4.1.26 të LPP-së si dhe në “Informimin Publik” të publikuar nga OSHP më datë 09/02/2023 konsiderohet si palë pa interes.

Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues Center for Legal Services L.L.C., janë vlerësuar si çështje e gjykuar (Res Judicata).

Ndërsa, I shqiptohet vërejtje e fundit Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit pran AK-së. Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik, si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi dhe respektimin e vendimeve të OSHP-së në të kundërtën OSHP mund të inicojë procedurat disiplinore konformë nenit 97 të Rregullorës për Prokurim Publik.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminojë ose dëmtojë një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Center for Legal Services L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: